

# PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2024

## HYRJE

### 1. Rëndësia dhe qëllimet e subjektit

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është i themeluar nga 9 njësi të vetëqeverisjes lokale të cilat bëjnë pjesë në rajonin planor Jugperëndimor.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor realizon aktivitete dhe punë të ndërlidhura me prioritetet zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor dhe atë:

- Përgatit Propozim-programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në pajtueshmëri me metodologjinë e përcaktuar dhe me dokumentet strategjike nacionale
- Përgatit Propozim-plan aksionar për implementimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- Përgatit propozim projekte rajonale për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor,
- I koordinon aktivitetet në lidhje me implementimin e Programit për zhvillim
- I realizon projektet rajonale për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- Përgatit Raport vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor,
- Siguron informacione nga palët e interesuara për rrjedhën e realizimit të Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor dhe çështje tjera të ndërlidhura me zhvillimin rajonal,
- Siguron ndihmë profesionale dhe teknike për njësitë e vetëqeverisjes lokale gjatë përgatitjes së programeve dhe projekteve të tyre
- Siguron informacione dhe konsulta për shoqatat e qytetarëve dhe palë të tjera të interesuara gjatë përgatitjes së projekteve të tyre nga sfera e zhvillimit rajonal
- Nxit bashkëpunimin ndër komunal në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor,
- Përgatit, dhe aplikon dhe realizon projekte për nxitjen e zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor, të cilat financohen nga Unioni Evropian dhe burime të tjera ndërkombëtare
- Bën promovimin e mundësive zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor,
- Realizon aktivitete për nxitjen e konkurrencës përmes përkrahjes aktive të sektorit privat,
- Kryen punë administrativo-teknike për nevojat e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor,
- Përgatit dhe realizon projekte dhe detyra dhe shërbime për ministritë dhe institucione tjera shtetërore dhe
- Kryen aktivitete tjera për nxitjen e zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor.

### 2. Burimet e financimit

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- Fondet e Unionit Evropian;
- Burime tjera ndërkombëtare;
- Donacione dhe sponsorizime nga persona fizik dhe juridik;

- Mjete të tjera të parapara me ligj.

Përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2023 dhe me mjete të projektuar për vitin 2024, sipas buxhetit të projektuar, për rajonin planor Jugperëndimor janë paraparë 58.483.425 denarë, nga të cilat 57.283.425 denarë janë për aktivitetet e projekteve, ndërsa 1.200.000 denarë për menaxhim të projekteve. Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor ka aplikuar deri te BZHR me tre projekte rajonale me shumë të përgjithshme prej 62.538.069 denarë. Këshilli nacional për zhvillim të barabartë rajonal i RMV i miratoi të tre projektet rajonale dhe dha propozim deri te Qeveria e RMV për financim të të njëjtave. Qeveria mori vendim për shpërndarjen e mjeteve për projekte rajonale në fund të muajit nëntor të vitit 2023. Duke marrë parasysh faktin që marrëveshjet për realizim janë nënshkruar në muajin nëntor 2023, mjetet dhe një pjesë më e madhe e aktiviteteve të projekteve do të barten në vitin e ardhshëm 2024. Qendra për zhvillim të RPJP planifikon të aplikojë me projekt rajonal tek Ministria e vetëqeverisjes lokale nga Programi për konkurrencë dhe tejkallim të disparitetëve për vitin 2024, për vlerë prej 3.000.000 denarë. Gjithashtu, Qendra planifikon të aplikojë me propozim projekt tek Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural për Masën 321 nga Programi për zhvillim rural për vitin 2023. Gjithashtu, do të aplikohet me projekt tek Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave përmes Programit për Investime kapitale në rajonet planore për përmirësimin e qasjes deri te tokat e punueshme bujqësore për vitin 2024. Me Ministrinë për vetëqeverisje lokale u nënshkrua një Marrëveshje për përkrahjen e Qendrës për zhvillim të RPJP dhe pritjet të nënshkruhet edhe një Marrëveshje tjetër, për përkrahjen e Qendrës për zhvillim dhe Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me mjete të siguruara përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025” një pjesë nga buxheti nacional dhe një pjesë nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), dhe Marrëveshje për bashkëpunim për vitin 2024 mjete nga MVL. Në fund të vitit 2022 dhe në fillim të vitit 2023 janë nënshkruar tre marrëveshje me Ministrinë e vetëqeverisjes lokale për realizimin e projekteve investuese me komponentë digjitale (ISHP Kardiologjia Ohër, ISHP Nefrologjia Strugë, dhe ISHP Shën.Erazmo Ohër) përmes Shemës së granteve, e cila financohet përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025”. Gjithashtu me UNDP është nënshkruar Marrëveshje për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projektet për projekte infrastrukturore prioritare në lartësi prej 4.080.071 denarë nga të cilat 40% janë kontribut vetanak i komunave partnere. Të gjitha projektet e përmendura janë pjesë përbërëse e Planit financiar për vitin 2024.

### 3. Tabelat financiare

- Në Tabelën 1 janë përshkruar të hyrat e planifikuara për vitin 2024.
- Në Tabelën 2 janë përshkruar shpenzimet e planifikuara për vitin 2024.

Pas çdo tablele është dhënë përshkrimi për zërat e veçantë.

Tabela 1 pjesa e parë

**TË HYRAT E PLANIFIKUARA 2024**

<b>TË HYRAT E PLANIFIKUARA 2024</b>				Shuma në denarë	
Nr.re n.	Nr.llog.	Emri i llogarisë	PËRSHKRIMI	2023	2024
	<b>74</b>	<b>Transfere dhe donacione</b>			
1	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Vevçanit (participimi në projekt)	321.330,00	543.533,00
2	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Dibrës (participimi në projekt)	321.330,00	401.612,00
3	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Debërcës (participimi në projekt)	229.725,00	458.473,00
4	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës (participimi në projekt)	321.330,00	490.979,00
5	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Makedonski Brodit (participimi në projekt)	316.325,00	405.000,00
6	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Ohrit (participimi në projekt)	321.330,00	555.004,00
7	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Pllasnicës (participimi në projekt)	321.330,00	512.209,00
8	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Strugës (participimi në projekt)	413.024,00	663.750,00
9	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Qendër Zhupës (participimi në projekt)	326.244,00	659.797,00
10	741112	Transferime nga Buxheti i RMV	Transferimi i mjeteve nga MVL – rrjedhëse	1.200.000,00	1.200.000,00
11	741112	Transferime nga Buxheti i RMV	Transferimi i mjeteve nga BZHR – menaxhimi i projekteve	1.200.000,00	1.200.000,00
		<b>GJITHSEJ 1:</b>		<b>5.291.968,00</b>	<b>7.090.357,00</b>

Tabela 1 pjesa e dytë

TË HYRAT E PLANIFIKUARA 2024				Shuma në denarë	
Nr.ren.	Nr.llog.	Emri i llogarisë	PËRSHKRIMI	2023	2024
12	741114	Teprica e bartur e të hyrave nga viti i kaluar	Gjendja në 31.12	7.700.000,00	5.000.000,00
13	741211	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2022/2023 BZHR (PR ZHBR)	47.183.881,00	7.796.475,00
14	741214	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Kofinancimi i komunave në projekte rajonale 2022/2023	6.344.892,00	0,00
15	741211	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2023/2024 – BZHR (PR ZHBR)	0	57.283.425,00
16	741211	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale – Programi për konkurrencë 2024	0	3.000.000,00
17	741211	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2024 – Prog. për zhvillim rural APFBZHR	0	20.000.000,00
18	741214	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Kontributi vetanak i komunave në projekte rajonale 2024 - PZHB	0	3.600.000,00
19	741211	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Përmirësimi i qasjes deri te tokat e punueshme (MBPU- Prog.inv.kap. 2024)	3.000.000,00	3.000.000,00
20	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 1 (Kardiologjia) ZHBRQI (2021-2025)	10.261.996,00	10.261.997,00
21	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 1 (Kardiologjia) Menaxhimi ZHBRQI (2021-2025)	174.018,00	300.000,00
22	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 1 (Kardiologjia) Kontributi vetanak ZHBRQI (2021-2025)	0	2.916.960,00
23	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 2 (Nefrologjia) ZHBRQI (2021-2025)	10.262.000	10.262.000,00
24	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 2 (Nefrologjia) Menaxhimi ZHBRQI (2021-2025)	230.000,00	400.000,00
25	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Shema e granteve Projekti 2 (Nefrologjia) Kontributi vetanak ZHBRQI (2021-2025)	2.773.422,00	2.170.744,00
26	742119	Të hyra nga SDC	Shema e granteve Projekti 3 (Shën Erazmo) ZHBRQI (2021-2025)	1.927.200,00	1.927.200,00
27	742119	Të hyra nga SDC	Shema e granteve Projekti 3 (Shën Erazmo) Kontributi vetanak ZHBRQI (2021-2025)	464.800,00	464.800,00
28	742119	Të hyra nga MVL dhe SDC	Përkrahja e Qendrës për zhvillim të RPJP – ZHBRQI (2021-2025)	217.000,00	271.500,00
29	742119	Të hyra nga UNDP, BZHR dhe komunat (Fondi për dokumentacion teknik)	Përgatitja e dokumentacionit teknik për projekte infrastrukturore prioritare (UNDP, BZHR dhe Komunat)	1.224.021,00	4.080.071,00
		<b>GJITHSEJ 2</b>		<b>91.763.230,00</b>	<b>132.680.672,00</b>
		<b>GJITHSEJ:</b>		<b>97.055.198,00</b>	<b>139.825.529,00</b>

\* Shënim - Këshillat e NJVL duhet në buxhetet e komunave për vitin 2024 të miratojnë zëra për pjesëmarrje vetanake në projekte rajonale

## **Përshkrimi i zërave të të hyrave**

Zërat nga numri rendor 1 deri te numri 9 – përfshin të hyrat në bazë të transferimeve të mjeteve nga buxhetet e të gjithë 9 komunave të cilët janë shfrytëzuesit e fundit e projekteve rajonale, për participim (deri në 15% nga vlera e përllogaritur e projektit) për projekt të miratuar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për realizimin dhe implementimin e projektit, në pajtim me nenin 31 pika 5, 6, 7, 8 dhe 9 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (Gazeta zyrtare nr.24/21 dhe 174/21), dhe në pajtim me nenin 8 nga Ndryshimet dhe plotësimet e Vendimeve për themelimin të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor të miratuara nga ana e Këshillave komunal në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor.

Zëri me numër rendor 10 – i përfshin të hyrat në bazë të transferimit të mjeteve nga Ministria e vetëqeverisjes lokale në pajtim me nenin 31 pika 1, 2, 3 dhe 4 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal dhe Marrëveshjes për bashkëpunim për vitin 2024 i cili do të nënshkruhet nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Zëri me numër rendor 11 i përfshin edhe të hyrat si transfere nga Byroja për zhvillim rajonal për menaxhimin e projekteve rajonale të cilat janë miratuar për financim për Qendrën për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, në pajtim me nenin 43 pika 7 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal.

Zëri me numër rendor 12 – i përfshin të hyrat në bazë të bartjes së mjeteve në pajtim me gjendjen e llogarisë duke përfshirë datën 31.12.2023.

Zëri me numër rendor 13 – mjete të fituara përmes programeve për ZHBR të MVL dhe BZHR për vitin 2022 dhe të planifikuara për vitin 2023, për projekte rajonale për të cilat Qendra aplikoi deri te BZHR gjatë vitit 2022. Një pjesë më e madhe e aktiviteteve u realizuan gjatë vitit 2023, dhe vetëm një aktivitet në Dibër bartet për vitin tjetër që të realizohen përfundimisht në vitin 2024.

Zëri me numër rendor 15 – i përfshin mjetet e parapara në Programet për ZHBR të BZHR për vitin 2023/2024 për projekte rajonale për të cilat QZHRPJP aplikoi deri te BZHR gjatë vitit 2023, të njëjtat janë miratuar dhe realizohen gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Zëri me numër rendor nr.16 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për zvogëlimin e dispariteteve në dhe në mes rajoneve planore dhe rritjen e konkurrencës rajonale për vitin 024 të MVL, për të cilat Qendra për zhvillim do të aplikojë deri te MVL dhe pas miratimit do të realizohen në vitin 2024.

Zëri me numër rendor 17 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për zhvillim rural për vitin 2023 për të cilat Qendra do të aplikojë deri te Agjencia për përkrahje financiare dhe mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural (Masa 321).

Zëri me numër rendor nr.18 – i përfshin të hyrat në bazë të kontributit vetanak të komunave në projektet rajonale nga zëri me numër rendor 17 (mjetet janë për TVSH)

Zëri me numër rendor nr.19 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për investime kapitale në rajonet planore për vitin 2024 për të cilat Qendra do të aplikojë tek MBPU.

Zëri me numër rendor nr.20 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, për kofinancim të projektit rajonal investues me komponentë digjitale (Kardiologjia në Ohër) përmes Shemës së granteve nga Projekti ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025.

Zëri me numër rendor nr.21 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, përmes projektit ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025, për menaxhimin e projektit investues nga zëri rendor nr.20.

Zëri me numër rendor nr.22 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve për kontribut vetanak nga shfrytëzuesi përfundimtar i projektit investues me komponentë digjitale nga zëri me numër rendor 20.

Zëri me numër rendor nr.23 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, për kofinancim të projektit rajonal investues me komponentë digjitale (Nefrologjia Strugë) përmes Shemës së granteve nga Projekti ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025.

Zëri me numër rendor nr.24 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, përmes projektit ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025, për menaxhimin e projektit investues nga zëri rendor nr.23.

Zëri me numër rendor nr.25 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve për kontribut vetanak nga shfrytëzuesi përfundimtar i projektit investues me komponentë digjitale nga zëri me numër rendor 23.

Zëri me numër rendor nr.26 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, për kofinancim të projektit rajonal investues me komponentë digjitale (Shën Erazmo Ohër) përmes Shemës së granteve nga Projekti ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025.

Zëri me numër rendor nr.27 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve për kontribut vetanak nga shfrytëzuesi përfundimtar i projektit investues me komponentë digjitale nga zëri me numër rendor 26.

Zëri me numër rendor nr.28 – i përfshinë të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC dhe MVL, për përkrahjen e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, përmes Projektit Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025.

Zëri me numër rendor nr.29 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga UNDP, BZHR dhe Komunat, për kofinancim të projekteve rajonale “Përgatitja e dokumentacionit teknik për projekte infrastrukturore prioritare” përmes Fondit për dokumentacion teknik i përkrahur nga Qeveria Suedeze, UNDP dhe Byroja për zhvillim rajonal.

Tabela 2 pjesa e parë

### SHPENZIMET E PLANIFIKUARA 2024

Nr.ren.	Konto	P Ë R S H K R I M I	Shuma në denarë
	<b>40</b>	<b>Pagat dhe kompensimet</b>	
1	401, 402	Bruto pagat	5.373.438,00
2	404	Kompensime (regres pushim vjetor)	120.000,00
	<b>41</b>	<b>Shpenzime të papërcaktuar rezerve</b>	
3	413	<i>Rezervat rrjedhëse (shpenzime të ndryshme)</i>	472.376,00
	<b>42</b>	<b>Stoqet dhe shërbimet</b>	
4	4201	Shpenzime rruge dhe mëditje brenda shtetit	50.000,00
5	4202	Shpenzime rruge dhe mëditje jashtë shtetit	100.000,00
	421	<i>Shërbime komunale, ngrohje, komunikim, transport</i>	
6	4211	Shërbime komunale	50.000,00
7	4213	Shërbime komunikimi	370.000,00
8	4214	Shërbime transporti	630.000,00
	423	<i>Materiale dhe inventar i imët</i>	

9	4231	Punë administrative	205.000,00
10	4232	Materiale për AOP	80.000,00
11	4234	Produkte ushqimore dhe pije	100.000,00
12	4237	Materiale për riparim dhe mirëmbajtje	74.000,00
	424	<i>Riparime dhe mirëmbajtje vijuese</i>	
13	4241	Riparime dhe mirëmbajtje të veturave	100.000,00
14	4242	Riparime dhe mirëmbajtje të ndërtesave	130.000,00
15	4244	Riparime dhe mirëmbajtje të mobilieve dhe makinerive	60.000,00
	425	<i>Shërbime kontraktuese</i>	
16	4251	Huamarrja e sallave dhe pajisjeve	60.000,00
17	4252	Shërbime bankare dhe sigurime	30.000,00
18	4253	Shërbime gjyqësore dhe juridike	350.000,00
19	4254	Shërbime shëndetësore (kontroll vjetor i rregullt)	20.000,00
20	4259	Shërbime tjera kontraktuese	1.272.500,00
21	401320	Tatim personal nga shërbimet kontraktuese	28.664,00
	426	<i>Shpenzime tjera rrjedhëse</i>	
22	4261	Anëtarësime në organizata	60.000,00
23	4262	Shpenzime për reprezentacion	105.000,00
24	4263	Seminare dhe konferenca	50.000,00
25	4264	Shpallja e konkurseve	200.000,00
26	4269	Shpenzime tjera operative	200.000,00
	464	<i>Transfere të ndryshme</i>	
27	464940	Transfere gjatë pensionimit	303.879,00

Tabela 2 pjesa e dytë

### **SHPENZIMET E PLANIFIKUARA 2024**

Nr. ren.	Konto	P Ë R S H K R I M I	Shuma në denarë
	<b>48</b>	<b>Shpenzimet kapitale</b>	
28	48	Projekte rajonale përmes Programit ZHBR 2022/2023 - BZHR	7.796.475,00
29	48	Projekte rajonale përmes Programit ZHBR 2022/2023 – koofinancim i komunave partnere	0,00
30	48	Projekte rajonale përmes Programit ZHBR 2023/2024 - BZHR	57.283.425,00
31	48	Projekte rajonale përmes Programit për konkurrencë 2024	3.000.000,00
32	48	Projekte rajonale përmes PR ZHR (APFBZHR) 2024	23.600.000,00
33	48	Shema e granteve 2022 (projekt investues) PR1 Kardiologjia - SDC MVL Projekti Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025	13.178.957,00
34	48	Shema e granteve 2022 (projekt investues) PR2 Nefrologjia - SDC MVL Projekti Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe	12.432.744,00

		inkluziv 2021-2025	
35	48	Përkrahje e Qendrës për zhvillim të RPJP (PR ZHBRQI 2021 – 2025)	271.500,00
36	48	Shema e granteve 2022 (projekt investues) PR3 Shën Erazmo - SDC MVL Projekti Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025	2.392.000,00
37	48	Përgatitja e dokumentacionit teknik për projekte infrastrukturore prioritare – FDT (UNDP, Qeveria Suedeze, BZHR)	4.080.071,00
38	48	Projekti Përmirësimi i qasjes deri te tokat bujqësore në RPJP – Prog.Invest.Kapit. në RP 2024 - MBPU	3.000.000,00
	<b>480</b>	<b><i>Blerja e pajisjeve dhe makinerive</i></b>	
39	4801	Blerja e pajisjeve	200.000,00
40	4831	Blerja e mobilieve	50.000,00
41	4852	Softuer kompjuterik	200.000,00
	<b>486</b>	<b><i>Blerja e automjetit</i></b>	
42	486110	Blerja e automjetit	1.800.000,00
		<b>GJITHSEJ:</b>	<b>139.825.529,00</b>

### **Përshkrimi i zërave të shpenzimeve**

Zëri me numër rendor 2 – i përfshin shpenzimet në bazë të regresit për pushim vjetor për 5 të punësuar.

Zëri me numër rendor 6 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve komunale – energji elektrike, ujësjellës dhe kanalizim, mbeturinat.

Zëri me numër rendor 7 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve për komunikim – telefon, internet, pajisje komunikuese, certifikate digjitale, përgatitja, hostimi dhe azhurnimi i UEB faqes.

Zëri me numër rendor 8 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve transportuese – gaz dhe vajra për Automobilin, regjistrimi i automobilit, transporti i mallrave, transporti i personave.

Zëri me numër rendor 9 – i përfshin shpenzimet me bazë për punë administrative – materiale zyre, shërbime për kopjim, botime, parapagimi i revistave, gazetave dhe botime tjera për shfrytëzim nga të punësuarit, materiale tjera administrative, shërbime nga Regjistri Qendror, shërbime postare.

Zëri me numër rendor 10 – i përfshin shpenzimet me bazë materiale për AOP – tonerë për printerë dhe fotokopje, material i harxhuar për telefoni, materiali i harxhuar për lidhje kompjuterike dhe instalim, galanteri kompjuterike.

Zëri me numër rendor 11 – i përfshin shpenzimet në bazë të produkteve ushqimore dhe pije – pije për zyrë, pije për takimet me grupet e punës.

Zëri me numër rendor 13 – i përfshin shpenzimet në bazë të riparimit dhe mirëmbajtjes së veturave – pajisje dimri e detyrueshme për automobilin, mirëmbajtje e rregullt, pjesë rezerve dhe goma.

Zëri me numër rendor 14 - i përfshin shpenzimet në bazë të riparimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesës – materiale për riparime të ndryshme, shërbime për sigurimin e hapësirave dhe pajisjeve.



Zëri me numër rendor 16 - i përfshin shpenzimet në bazë të huamarrjeve të hapësirave dhe pajisjeve – huamarrje e sallave me pajisje për takime, huamarrja e tendave për panaire.

Zëri me numër rendor 17 - i përfshin shpenzimet në bazë të shpenzimeve bankare dhe sigurimeve – provizione bankare, sigurimi i të punësuarve, sigurimi i patundshmërive dhe pajisjeve, sigurimi i automjeteve.

Zëri me numër rendor 18 - i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve gjyqësore dhe juridike – shërbime juridike, përkthyes gjyqësor, ekspertiza dhe analiza gjyqësore.

Zëri me numër rendor 20 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve tjera kontraktuese – përkthyes; shërbime për pastrim; kontabilitet; shërbime për botim dhe editim; shërbime konsulente; prezantimi në medime dhe marketing; revizione nga shtëpi të pavarura reviduese; shërbime tjera kontraktuese; mbikëqyrje mbi mirëmbajtje dhe ndërtim.

Zëri me numër rendor 24 – i përfshin shpenzimet për konferenca dhe seminare – pagesë për pjesëmarrje.

Zëri me numër rendor 27 – i përfshin shpenzimet në bazë të transferove për pensionim, në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës, pjesa Sistem për paga dhe kontribute për paga për të punësuarit në Qendrën për zhvillim të RPJP, në nenin 29 nga e njëjta përcaktohet mënyra e pagesës së pensionimit për të punësuarit që dalin në pension.

Zëri me numër rendor 28 - i përfshin shpenzimet kapitale nga mjetet e bartura nga BZHR për projekte rajonale për vitin 2022/2023 në pajtim me zërat e planifikuara për ZHBR nga buxheti nacional për vitin 2022 dhe të planifikuara për vitin 2023, me të cilat realizohet aktivitetet në Dibër.

Zëri me numër rendor 30 - i përfshin shpenzimet kapitale nga mjetet e parapara për rajonin planor Jugperëndimor nga BZHR për projekte rajonale për vitet 2023/2024 në pajtim me zërat e projektuar për ZHBR në buxhetin nacional për vitin 2023 dhe indikative për vitin 2024.

Zëri me numër rendor nr.31 – i përfshin shpenzimet në bazë të projektit rajonal përmes Programit për tejkalimin e dispariteteve dhe nxitjen e konkurrencës rajonale për vitin 2024.

Zëri me numër rendor 32 – i përfshin shpenzimet në bazë të Projektit përmes Programit për zhvillim rural për vitin 2024 - Masa 321. Në të njëjtën konto është përfshirë edhe kontributi vetanak.

Zëri me numër rendor 33 dhe 34 – i përfshin shpenzimet për projekte përmes Shemës së granteve për projekt investues me komponentë digjitale përmes Projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” të SDC dhe MVL, në pajtim me marrëveshjet e nënshkruara për rikonstruktimin e ISHP kardiologjisë në Ohër dhe ISHP Nefrologjisë në Strugë. Në të njëjtën pjesë është përfshirë edhe kontributi vetanak i shfrytëzuesve final.

Zëri me numër rendor 35 – i përfshin shpenzimet në bazë të përkrahjes së Qendrës për zhvillim të RPJP përmes Projektit Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025.

Zëri me numër rendor nr.36 – i përfshin shpenzimet për projektin përmes Shemës së granteve për projekt investues përmes Projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv 2021-2025” të SDC dhe MVL, furnizimi i pajisjeve plotësuese për ISHP SHën Erazmo Ohër.

Zëri me numër rendor 37 – i përfshin shpenzimet për projektin “Përgatitja e dokumentacionit teknik për projekte infrastrukturore prioritare” përmes Fondit për dokumentacion teknik me mjete financiare nga UNDP, Qeveria suedeze, Byroja për zhvillim rajonal dhe komunat partnere në projekt.

Zëri me numër rendor 38 – i përfshin shpenzimet në bazë të projektit (Përmirësimi i qasjes deri te tokat punuese në RPJP) përmes Programit për subvencione kapitale për zhvillim të rajoneve planore në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural 2024 të MBPU.

Zëri me numër rendor 39 - i përfshin shpenzimet në bazë të blerjes së pajisjeve – pajisje kompjuterike, pajisje zyre, pajisje informatike dhe video.

Zëri me numër rendor 41 - i përfshin shpenzimet në bazë të softuerit kompjuterik – softuer për menaxhment financiar, softuer për punën e arshivës, softuer për evidencë të projekteve dhe koordinim.

***Shpërndarja e mjeteve të planifikuara në anën e të hyrave dhe të dalave në planin Financiar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2024 është përgatitur në pajtim me Rregulloren për klasifikim të hyrave dhe Rregullores për klasifikim të shpenzimeve (Gaz. Zyrtare e RM nr. 76/2009), që zbatohet nga viti 2010. Duke e marrë parasysh llogarinë e thesarit të QZHRPJP me karakter qëllimor, Qendra nuk ka për detyrim që planin financiar ta dorëzojë tek zyrat e thesarit.***

Qendra për zhvillim të  
rajonit planor Jugperëndimor

U.d. Drejtor

Valon Kaba

Strugë  
21.10.2024